

Njoftimi i përqendrimit me të cilin Grupi Aricoma a.s. Republika Çeke, do të fitoj kontrollin mbi Sabris Shared services s.r.o., Republika Çeke dhe ndaj një pjese të biznesit të Sabris CZ s.r.o., Republika Çeke

(lënda nr. 08-139/2022)

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 14.10.2022, në Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Grupi Aricoma a.s. (Aricoma Group a.s.), me seli në Vinohradska 1511/230, Strashnice, 100 00 Pragë 10 Republika Çeke (Vinohradska 1511/230, 100 00 Prague 10, Czech Republic), synon të fitoj kontrollin e plotë mbi Sabris Shared serviles s.r.o. (Sabris Shared Services s.r.o.), me seli në Pekarzhska 621/7, Jinonice, 155 00 Pragë 5, Republika Çeke (Pekařská 621/7, Jinonice, 155 00 Praha 5, Czech Republic), dhe me disa biznese të TI- biznes SAP të Sabris CZ s.r.o. me seli në Pekarzhska 621/7, Jinonice, 155 00 Pragë 5, Republika Çeke (Pekařská 621/7, Jinonice, 155 00 Praha 5, Czech Republic).

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

Grupi Arikoma a.s. është një kompani holding që menaxhon pjesët në kompanitë bijë të saja - veçanërisht Autocont a.s. dhe Cleverlance Group a.s., AEC a.s.. Autocont fokusohet në zbatimin e projekteve të ndërmarrjeve të mëdha dhe klientëve të mëdhenj, zbatimin dhe mbështetjen e sistemeve të informacionit të biznesit të Microsoft Dynamics dhe ofron infrastrukturë TI, aplikacione të korporatave, mbështetje për proceset e biznesit, kujdesin ndaj klientit dhe sigurinë e TI-së. Cleverlance Group a.s. është aktiv përmes filialit të saj Cleverlance Enterprise Solutions i cili punon në fushën e zhvillimit të softuerit me sipas porosisë së klientit. AEC a.s. ofron teknologjitë e sigurisë, vlerësimin e sigurisë, shërbimet e mbrojtjes kibernetike dhe shërbimet këshillimore të GDPR/përputhshmërisë. Ato janë kompani që i përkasin Grupit KKCG.

Grupi KKCG investon në fusha të ndryshme biznesi, duke përfshirë lotaritë dhe lojërat e fatit, naftë dhe gaz, patundshmëri, industri dhe teknologji të zgjuara. Grupi menaxhon më shumë se 30 kompani në 18 vende të botës.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi KKCG është i pranishëm në tregun e terminaleve të video lotarisë dhe teknologjisë informatike përmes shoqërive të mëposhtme:

- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit KASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MACEDONIJA SHPK Shkup, me veprimtari parësore - lojërat e fatit dhe basteve;
- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit Video Lotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë - KASINOS AUSTRIA SHPK Shkup, me veprimtari parësore - lojërat e fatit dhe basteve;
- Seavus SHPKNJP Shkup, me aktivitet parësore - programim kompjuterik; dhe
- Qendra për edukim dhe zhvillim Seavus SHPKNJP Shkup, me aktivitet parësor - arsim tjetër që nuk përmendet diku tjetër.

Sabris Shared services s.r.o., merret me ofrimin e shërbimeve që lidhen me zbatimin e shërbimeve SAP për klientët. Përmes mjetit të lëndës, Sabris CZ s.r.o. merret me zbatimin e SAP dhe menaxhimin e përmbajtjes së ndërmarrjes për klientët në industrinë e automobilave, shitjes me pakicë dhe logjistikës dhe industrinë e procesit.

Pas marrjes së **Sabris Shared services s.r.o.**, nga Aritzoma a.s., **Sabris shared services s.r.o.** do të fitonte një biznes të caktuar të TI-së - biznes SAP nga Sabris CZ s.r.o.

Sipas parashtruesit të njoftimit, tregu relevant për qëllime të vlerësimit të këtij përqendrimi mund të përkufizohet si treg për shërbime të teknologjisë informatike ("TI") në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

21.10. 2022

Shkup